



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Shkenca Kompjuterike**

Fakulteti	Shkencat dhe Teknologjitë Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	240
Kodi	BI-240
Titulli	Inxhinier i Diplomuar në Shkenca Kompjuterike Drejtimi: Informatikë Biznesi
Numri në arkiv i akreditimit [240]	03-39/2
Data akreditimit	23.04.2019

Përshkrimi i programit

Programi i studimor Shkenca Kompjuterike - Informatikë Biznesi, e bashkon më të mirën nga mjedisi i biznes-ambientit dhe nga perspektivat teknologjike, të cilat në mënyrë gjithëpërfshirëse i japin impuls zhvillimit bashkëkohor të industrisë dhe njëkohësisht përgatiten studentët për pozita udhëheqëse në organizatat në mbarë botën. Tregu i punës tashmë po kalon nëpër një ekspansion rapid, në të njëjtën mënyrë siç lëvizin shoqëria dhe ekonomia e këtij vendi drejt standardeve të Bashkimit Evropian dhe drejt globalizmit në përgjithësi.

Në suazat e programit janë përfshirë studime, të cilat për nga natyra janë dinamike, integruese dhe interaktive. Pritet që këto studime të gjenerojnë rezultate të larta profesionale, të përshtatura për nevojat e tregut të punës, të cilat njëherësh, do të shërbejnë si një bazë solide për studime të mëtutjeshme në nivel pasuniversitar.

Përmes këtij programi studimor, adresohen nevoja dhe trende specifike të cilat i përmbushin nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës në fusha të caktuara të zhvillimit korporativ lidhur me menaxhmentin dhe udhëheqjen e sistemeve informative dhe me zhvillimin e tyre. Programi, gjithashtu përfshin edhe: zhvillimin e portaleve, teknologjitë dhe projekte multimediale, aplikacione TI për biznese të reja, bazat e të dhënave, rrjetën e vlerave vargore, e-tregti, marketingun interaktiv, menaxhimin e marrëdhënieve me konsumatorët (CRM), konvergencën e biznesit dhe biznesin virtual, financat korporative dhe kontabilitetin.

Përmes këtij Programi studentët seriozisht do ta kuptojnë dhe do ta njohin fushën e biznesit dhe shkencave kompjuterike, njëkohësisht duke u orientuar në lëmenj të caktuar të cilat janë të paraparë në ciklin e dytë të studimeve. Gjatë studimeve studimor studentëve u jepen mundësi për punë praktike (internship), me çka do të aftësohen për t'i aplikuar njohuritë dhe aftësitë e fituara në fushën e informatikës së biznesit.

Universiteti aktualisht posedon IT infrastrukturë të shkëlqyer për realizimin e planprogramit me laboratorë kompjuterikë, me qasje në internet dhe me mundësi për mësim nga larg (distance learning), si dhe bibliotekë me burime të disponueshme online për kërkim.

Struktura e planprogramit mësimor paraqet një kombinim të balancuar të diturive themelore dhe të shkathtësive specifike profesionale. Viti i parë është posaçërisht i rëndësishëm për studentët, për shkak se bashkon një spektër të tërë të lëndëve interdisiplinore me zbatim praktik nga të dyja fushat, të biznesit dhe informatikës. Kjo do të jetë në dobi të jashtëzakonshme për formimin e tyre profesional.

Qëllimet arsimore të programit:

- T'u mundësohet studentëve hulumtimi i pavarur, duke hyrë në ato fusha të Informatikës së Biznesit, të cilat nuk kanë qenë të përfshira me planprogramin mësimor;
- Të zhvillojnë aftësi për qasje kritike, analitike dhe funksionale, aftësi krahasuese për zgjidhjen e problemeve që mund të

aplikohen në fushën e Informatikës së Biznesit;

- Të ofrohet mundësia për zhvillimin e aftësive personale, të komunikimit, hulumtimit dhe të aftësive të tjera të rëndësishme të nevojshme për punësim;
- Të ofrohet mundësia për njohje dhe fitim të përvojave të para të punës në një ambient real të punës nga lëmi i studimit, nëpërmjet punës praktike dhe përmes stazhimit.
- Të potencohet mësimi shumëgjuhësor dhe të promovohet dialogu ndëretnik dhe ndërkulturor;
- Të fitohen njohuri dhe shkathtësi nga disiplinat themelore të Informatikës së biznesit: programimi, bazat e të dhënave, rrjetat kompjuterike, ueb-teknologjitë e avancuara, financat korporative, menaxhmenti, marketingu si dhe implementimi i tyre në fusha të ngjashme.

Karriera

Të diplomuarit mund të gjejnë punë në fushat e zhvillimit të sistemeve, menaxhimit të projekteve softuerike, mund t'u bëhen mbështetje përdoruesve përfundimtarë të IT, të punojnë në programim dhe të jenë si analistë të sistemeve të biznesit. Për këtë arsye, personat që kanë jo vetëm aftësinë për të hartuar zgjidhje teknike të bazuara në kompjuter, por gjithashtu kanë mundësinë të njihen me mundësitë e TI nga një perspektivë e biznesit, do të kërkohen për punësim nga çdo organizatë. Studentët do të pajisen me aftësitë e mëposhtme.

- Të menaxhojnë informacionin në organizata të mesme dhe të mëdha.
- Të analizojnë, të planifikojnë dhe të zhvillojnë zgjidhje nga TI që mbështesin nevojat e tregut.
- T'i planifikojnë analizat nevojshme të biznesit dhe vlerësimet e rrezikut të biznesit.
- T'i zhvillojnë aftësitë, të kontribuojnë në marrjen e vendimeve, hartimin dhe zbatimin e ndryshimeve në procesin e biznesit.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Posedimi i diturisë dhe të kuptuarit nga lëmenjtë e biznesit dhe informatikës (ekonomi, menaxhment, marketing, financa, programim, baza të të dhënave, sisteme kompjuterike dhe të informacionit, rrjeta dhe inxhinieri të të dhënave).
- Aftësim për zhvillim dhe zbatim të ideve origjinale dhe kreative në mjediset, ku përputhen, ose janë të ndërlidhura fushat e biznesit dhe informatikës.
- Aftësi për zbatim të diturisë ndërdisiplinore dhe për demonstrimin e kompetencave specialistike nga informatika e biznesit.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aftësi për zgjidhjen kritike, të pavarur dhe kreative të problemeve në mjedise të reja ose në mjedise në të cilat studentët nuk kanë përvojë paraprake në kontekstin multidisiplinar në mjedisin real të biznesit ose të mjedisit organizativ.
- Planifikim, udhëheqje dhe vlerësim i hulumtimeve të pavarura në lëmin e biznesit, duke implementuar mjete të duhura llogaritëse, mjedise dhe teknologji.
- Kreativitet dhe origjinalitet në interpretimin e dijeve nga biznes proceset dhe përdorim i duhur i veglave kompjuteriketë bazuara në teknika të definuara për kërkim dhe hulumtim.

Aftësitë për të vlerësuar

- Aftësi për integrim kreativ dhe sintetizë të njohurive nga shumë lëmenj, që lidhen me biznes proceset dhe me përdorimin e veglave dhe teknikave kompjuterike.
- Aftësi për t'u ballafaquar me situata komplekse, që lidhen me proceset e biznesit, për t'i identifikuar rastet përkatëse të instancave të specializuara në lëmin e Biznesit dhe Informatikës dhe për të sjellë vlerësime të qëndrueshme në situata kur ka mungesë të informacionit të plotë, ose të të dhënave dhe në bazë të parimeve dhe përgjegjësive personale, shoqërore që lidhen me zbatimin e diturisë dhe të të kuptuarit.

Aftësitë e komunikimit

- Aftësi për performim të qartë dhe të pa mëdyshje të konkluzioneve profesionale, për rezultate, studime dhe njohuri me aftësi për përshtatjen e stilit dhe të formës të shprehjes.
- Kompetencë për hulumtime kritike, të pavarura dhe të argumentuara në mënyrë kreative, vlerësim të metodologjive dhe propozim apo mbrojtje të hipotezave të reja.
- Aftësi për inicim, udhëheqje dhe marrje të përgjegjësive për individë dhe grupe në raste kur kompetencat e biznesit dhe kompetencat informatike janë me rëndësi thelbësore.

Aftësitë e të mësuarit

- Aftësi për identifikimin e nevojave dhe drejtimeve personale për riedukim personal dhe autonom, si dhe për performimin e tij në mënyrë të pavarur dhe autonome në fushat e zakonata të lëmenjve të biznesit dhe të lëmenjve informatikë.
- Aftësi për të marrë përgjegjësi për mësim të vazhdueshëm individual në fusha të specializuara të lëmenjve të biznesit dhe informatikës në kuadër të ekonomisë së rrjetëzuar.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [CCS-203] [6.0 SETK] **Programimi**
- [CCS-101] [6.0 SETK] **Hyrje në Shkenca Kompjuterike**
- [CBI-103] [6.0 SETK] **Hyrje në Ekonomi**
- [ACS-103] [6.0 SETK] **Algjebra Lineare**
- [3.0 SETK] **Gjuhë Shqipe/Maqedonase**
- [3.0 SETK] **Gjuhë Angleze**

Semestri 2

- [CCS-102] [6.0 SETK] **Teknologjitë e Internetit**
- [CCS-303] [6.0 SETK] **Programimi i Orientuar në Objekte**
- [ACS-204] [6.0 SETK] **Kalkulus**
- [3.0 SETK] **Gjuhë Shqipe/Maqedonase**
- [3.0 SETK] **Gjuhë Angleze**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Gjuhë, Shkathtësi ose Kulturë)**

Semestri 3

- [CBI-201] [6.0 SETK] **Parimet e Menaxhmentit**
- [CBE-101] [6.0 SETK] **Parimet e Marketingut**
- [CBI-203] [6.0 SETK] **Strukturat Diskrete**
- [CCS-301] [6.0 SETK] **Algoritmet dhe Strukturat e të Dhënave**
- [6.0 SETK] **Gjuhë Angleze për Qëllime Specifike**

Semestri 4

- [CBE-201] [6.0 SETK] **Parimet e Kontabilitetit**
- [CCS-403] [6.0 SETK] **Bazat e të Dhënave**
- [CCS-402] [6.0 SETK] **Probabiliteti dhe Statistika**
- [CBI-402] [6.0 SETK] **Bazat e Sistemeve të Informacionit**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Gjuhë, Shkathtësi ose Kulturë)**

Semestri 5

- [CCS-501] [6.0 SETK] **Ueb Programimi**
- [BE-501] [6.0 SETK] **Financat e Korporatave**
- [CCS-502] [6.0 SETK] **Inxhinieria e Softuerit**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Profesionale)**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Profesionale)**

Semestri 6

- [CBI-605] [6.0 SETK] **Inteligjenca e Biznesit**
- [ECS4060] [6.0 SETK] **Interakcioni Njeri - Kompjutor**
- [CBI-603] [6.0 SETK] **Sistemet Sfariste Informative**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Profesionale)**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Profesionale)**

Semestri 7

- [EMI-201] [6.0 SETK] **Vizualizimi i Informacionit**
- [CCS-701] [6.0 SETK] **Menaxhimi i Projekteve**
- [BI-701] [6.0 SETK] **Modelimi i Proceseve të Biznesit**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Profesionale)**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Profesionale)**

Semestri 8

- [BI-801] [6.0 SETK] **Marketingu Digjital**
- [CBI-607] [6.0 SETK] **Punim Diplome**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Profesionale)**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Profesionale)**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Programimi**

Kjo lëndë ofron një hyrje në programim dhe mbulon koncepte si tipat e të dhënave, aritmetikë, operatorë, komandat për hyrje-dalje, kushtet, strukturat ciklike, funksionet, rekurzivitetin, algoritmet me vektorë dhe matrica, algoritmet për kërkim dhe radhitje, pointerët dhe operacionet mbi to, deklarimin e strukturave të reja të të dhënave.

- **Hyrje në Shkenca Kompjuterike**

Kjo lëndë paraqet një hyrje të gjerë dhe të integruar në konceptet themelore të shkencave kompjuterike. Lënda mbulon tema, siç janë: historia e llogaritjes; logjika dhe sistemet digjitale; hyrje në arkitekturën kompjuterike, algoritme të thjeshta, zgjidhje problemesh dhe struktura të të dhënave; hyrje në gjuhët e programimit, sistemet operative, bazat e të dhënave, rrjetat, inxhinieria e softuerit dhe ueb-it; llojet e aplikacioneve, përfshirë edhe përshkrimin e disa programeve specifike (procesorë teksti, baza të dhënash, shfletues, etj.); procedimi i të dhënave tradicionale dhe multimediale.

- **Hyrje në Ekonomi**

Përmes kësaj lënde studentët do të njoftohen me rrethin e brendshëm dhe të jashtëm të ndërmarrjes. Me këtë rast kujdes i veçantë do t'i kushtohet funksionit financiar, funksionit të marketingut dhe funksionit organizativ të ndërmarrjes. Krahas kësaj, do të shqyrtohet edhe ndikimi i ndërmarrjes në shoqëri.

- **Algjebra Lineare**

Programi i kësaj lënde është dizajnuar ashtu që t'i njoftojë studentët me konceptet dhe metodat që e përbëjnë bazën e algjebërës lineare. Algjebra lineare në fakt paraqitet çdo kund. Konceptet e kësaj lënde shfrytëzohen në mënyrë të vazhdueshme çdokund pa u emërtuar. Integrali është linear, derivati është linear, etj. Pjesa më e madhe e zbatimit të matematikës në "jetën reale" vjen në shprehje përmes pjesës lineare. Ky është material mjaft me rëndësi për studentët e këtij drejtimi. Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje t'i shfrytëzojnë dhe t'i aplikojnë barazimet dhe zgjidhjet e tyre. Algjebërën e matricave. Transformimet lineare dhe shfrytëzimin e tyre në aplikacione. Hapësirat vektoriale. Vlerat veti dhe vektorët vetiakë të matricave reale. Determinantat dhe ortogonaliteti. Qëllim me rëndësi është të ndërliidhet algjebra lineare me lëmenjtë tjerë me ose pa përdorim të matematikës.

- **Teknologjitë e Internetit**

Qëllimi kryesor i lëndës është që t'u jep studentëve njohuri praktike mbi mekanizmat themelorë, shërbimet dhe protokollat e rrjetit global - Internetit. Lënda ofron mësimin e arkitekturës së përgjithshme të uebfaqeve efikase, skalabile dhe të sigurta. Studentët, do të fitojnë njohuri të thella teknike të XML, XHTML (listat, tabelat, figurat, multimedia dhe formularët), CSS (formatimi, stilet dhe layout-i), si dhe JavaScript (variablat, kushtet, ciklet dhe funksionet).

- **Programimi i Orientuar në Objekte**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me konceptet themelore të programimit të orientuar në objekte

përmes gjuhës programore C++. Për këtë qëllim shfrytëzohet koncepti i objekteve dhe klasave. Studentët do të njoftohen me trashëgiminë e klasave, me hierarkinë dhe me polimorfizmin. Pas kompletimit të kësaj lënde studentët, do të jenë në gjendje të kuptojnë parimet e gjuhës së orientuar në objekte dhe të jenë në gjendje të shkruajnë programe në gjuhën programore C++.

- **Kalkulus**

Përmes kësaj lënde studentët njoftohen që në tërësi t'i përvetësojnë kuptimet vijuese: funksionin (si pasqyrim i veçantë), mënyrat e paraqitjes së një funksioni, vazhdueshmërinë e funksioneve elementare. Gjithashtu aftësohen për përcaktimin e vlerave kufitare të funksioneve (limitet), derivatet, zgjidhjen e problemeve në lidhje me përcaktimin e monotonisë së funksioneve dhe vlerave minimale dhe maksimale të funksioneve elementare, me të vetmin qëllim përfundimtar që të vizatojnë grafikun e funksionit nga i cili do të mund të lexohen të gjitha vetitë dhe karakteristikat e funksioneve. Gjithashtu lënda ka për qëllim që studentët të njoftohen me kuptimin e integraleve dhe ta praktikojnë atë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme praktike.

- **Parimet e Menaxhmentit**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët që njoftohen me bazat e menaxhmentit, gjenezën dhe përkufizimin e tij, si dhe me parimet themelore në të cilat do të bazohet puna e secilit menaxher të ardhshëm. Ndjekja e kësaj lënde ka për qëllim, që studentët të përfitojnë njohuri themelore nga fusha e funksioneve bazike në menaxhment si planifikimi, organizimi, koordinimi, motivi dhe kontrolli. Të mësuarit e kësaj lënde studentëve, do t'u mundësojë: - Të mësojnë bazat e menaxhmentit dhe të aftësohen për to që të japin shembuj konkretë. - Të aftësohen ta shohin këtë lëndë si nevojë për fitimin e njohurive, të cilat do të jenë në kontekst të zbatimit në praktikë të asaj që kanë mësuar - Të mendojnë në mënyrë efikase që do t'u ndihmojë të përballen me problemet afariste në jetën e tyre të mëturshme.

- **Parimet e Marketingut**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njoftohen me konceptet themelore, të cilat janë ndërtuar në funksionet e marketingut në organizatat bashkëkohore. Fokusi është vendosur në konceptet, si dhe në çështjet lidhur me marketingun e prodhimeve dhe shërbimeve të konsumatorëve. Në mënyrë më specifike, qëllimi është që studentët ta njohin mjedisin e marketingut nëpërmjet analizës së tregut, që pastaj të implementohen strategjitë e suksesshme të marketingut në atë mjedis. Studentët, gjithashtu, do të mund t'i implementojnë konceptet shkencore për dizajnimin e planit të marketingut për produktin e tyre. Kjo lëndë u mundëson studentëve të njoftohen me aktivitetet e ndryshme në fushën e marketingut, të cilat kontribuojnë që kompania të jetë më konkurrense dhe më e suksesshme në treg.

- **Strukturat Diskrete**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuri matematikore të duhura që kanë zbatim të drejtpërdrejtë në fushën e informatikës së biznesit. Disa nga konceptet e parashikuara në këtë lëndë tashmë janë të njohura për studentët, por qëllimi këtu është t'i formalizojnë këto koncepte në një nivel akoma më të lartë, që do t'u mundësojë zgjerimin e diapazonit të tyre të ideve dhe këto t'i aplikojnë, duke zgjidhur probleme të ndryshme praktike.

- **Algoritmet dhe Strukturat e të Dhënave**

Lënda mundëson njohje me konceptet dhe parimet themelore për analizimin dhe hartimin e algoritmeve si dhe përdorimin e strukturave të ndryshme të algoritmeve. Shqyrton algoritme të ndryshme për zgjidhjen e një problemi të njëjtë. Në hollësi shqyrton kompleksitetin kohor dhe hapësinor të algoritmeve. Vendos kritere për gjetjen e algoritmit më të mirë. Studion hartimin e strukturave të ndryshme dhe tashmë të njohura të të dhënave (lineare dhe jolineare) dhe konsideron mundësinë e krijimit të strukturave të reja të të dhënave, si dhe zbatimin konkret të tyre. Pjesa e fundit e këtij moduli paraqet hyrje në grafe dhe shqyrtim të modeleve themelore të graf-algoritmeve. Studentët familjarizohen me lloje të ndryshme të të dhënave dhe algoritmeve, që më tej do t'u lejojë përfshirje të drejtpërdrejtë në analizimin, hartimin dhe zbatimin konkret të projekteve softuerike.

- **Parimet e Kontabilitetit**

Qëllimi i programit të lëndës është t'u ndihmojë studentëve ta kuptojnë thelbin e kontabilitetit, t'i mësojnë bazat, konceptet dhe parimet e kontabilitetit. Në mënyrë më specifike, studentët të fitojnë njohuri dhe t'i kuptojnë raportet financiare, komponentët e tyre, rregullat themelore të evidentimit të të dhënave kontabël, përdorimin e dokumenteve kontabël.

- **Bazat e të Dhënave**

Lënda paraqet hyrje në konceptet dhe sistemet e bazave të të dhënave. Studenti, i cili do ta përfundojë me sukses këtë modul, do të jetë në gjendje t'i shfrytëzojë modelet dhe konceptet e projektimit të bazave të të dhënave. Do të jetë në gjendje të përdorë dhe të hartojë baza të thjeshta dhe konkrete të të dhënave të bazuara në modelin

relacional. Po ashtu, do të mundë të përdorë MS SQL Server sistemin për menaxhimin e bazave të të dhënave (DBMS), SQL gjuhët dhe zbatimin e veprimeve (queries).

- **Probabiliteti dhe Statistika**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuritë themelore nga probabiliteti dhe statistika që kanë zbatim të drejtpërdrejtë në fushën e shkencave kompjuterike. Qëllimi është që të mësohet se si bëhet përpunimi i të dhënave statistikore, ligjshmëritë e tyre, paraqitja e tyre, ligjet për dhënien e konkluzioneve përkatëse bazuar në të dhënat e përpunuara, etj. Po ashtu, qëllimi është që të mësohen parimet themelore nga fusha e probabilitetit dhe se si mund të zbatohen ato parime në fushat e ndryshme nga jeta e përditshme posaçërisht në lëmin e shkencave kompjuterike.

- **Bazat e Sistemeve të Informacionit**

Qëllimet e lëndës: - T'i mësojnë konceptet themelore dhe terminologjinë e sistemeve të informacionit: Sistemet themelore të informacionit dhe konceptet - harduerë, softuerë, rrjete; E-World: e-biznes dhe e-tregti; Proceset zhvillimore. - Të mësojnë më shumë për sistemet dhe teknologjitë e informacionit, të cilat i përmirësojnë vlerat e biznesit dhe proceset e ndryshme të biznesit nëpër organizata. - T'i zbatojnë e-konceptet me disiplina të ndryshme menaxheriale, gjatë procesit të analizës, interpretimit, vlerësimit dhe marrjes së vendimeve. - Ta kuptojnë procesin e ridisejnit të organizatave me shfrytëzimin e sistemeve të informacionit. - Ta përshkruajnë rolin e sistemeve të informacionit në vendimmarrje. - Ta shqyrtojnë sigurinë e informacioneve, si dhe çështjet etike dhe sociale. - Të njihen me Internetin, tregtinë elektronike dhe e-biznesin. - Të aftësohen studentët për të punuar në projekte individuale dhe grupore, të cilat për nga natyra mund të jenë: studime të rastit, projekte hulumtuese shkencore, projekte zhvillimore ose punë praktike.

- **Ueb Programimi**

Kjo lëndë mbulon dizajnimin dhe zhvillimin e ueb aplikacioneve, përfshirë programimin në anën e klientit dhe atë të serverit. Gjithashtu, lënda përfshin edhe dizajnimin e bazave të të dhënave për ueb, gjuhët e programimit për ueb, si dhe integrimin e të dhënave në ueb aplikacione.

- **Financat e Korporatave**

Qëllimi i lëndës është transferimi i shkathtësive dhe njohurive të nevojshme teorike në fushën e menaxhimit financiar, si dhe përgatitja e studentëve me njohuri dhe me përvojë bashkëkohore teorike në analizën e koncepteve themelore të financave korporative, projekteve investuese financiare e reale dhe vlerësimi i tyre përmes dimensionit kohor të parave. Qëllimi i lëndës vazhdon me trajnimin e studentëve se si të përdorin burime adekuate të financimit, si ta bëjnë menaxhimin efikas të kapitalit dhe si ta bëjnë përcaktimin e strukturës adekuate, përcaktimin e politikës adekuate të shpërndarjes së fitimit - politikës së dividendit dhe si të bëhet finalizimi i planifikimit financiar dhe parashikimi, etj. Arritja e objektivave të synuara të lëndës, studentëve u krijon mundësi të reja për qasje më konkurruese në tregun e punës ose menaxhim më efikas të bizneseve të tyre reale.

- **Inxhinieria e Softuerit**

Qëllimi i lëndës është t'i pajisë studentët me njohuri të thella, kritike dhe sistematike për parimet dhe teknikat e specifikimit sistematik dhe softuerik; analiza dhe dizajn; programim, testim dhe vlerësim; mirëmbajtje dhe menaxhim të projekteve të aplikacioneve softuerike efikase. Studentët, do të kenë kuptim të qartë për mjetet dhe metodologjitë për zhvillim të zgjidhjeve softuerike.

- **Inteligenca e Biznesit**

Qëllimet e lëndës: Të përgatiten studentët që të jenë të gatshëm të ballafaqohen me problemet bashkëkohore të dizajnit, zhvillimit dhe menaxhimit të zgjidhjeve nga fusha e biznes intelecencës (BI). Me këtë studentët do të mësojnë për veglat dhe metodat e zhvillimit të sistemeve të IB-së, mbledhjen dhe analizën e të dhënave, bazat e gjurmimit të të dhënave, vizualizimit të të dhënave dhe aplikimi i tyre në biznes. Gjithashtu, studentët do të mësojnë edhe si të menaxhojnë me projekte nga fusha e IB-së, magazinat e të dhënave, ETL proceseve, sistemet e parashikimit, zhvillimin e IB-aplikacioneve etj.

- **Interakcioni Njeri - Kompjutor**

Kjo lëndë ka për qëllim t'u mundësojë studentëve njohuri të teorisë dhe të praktikave të zhvillimit të softuerit që lidhen me komunikimin ndërmjet njerëzve dhe kompjuterëve, me qëllim të krijimit të aplikacioneve që mund të përdoren lehtësisht. Lënda mbulon aspektet psiko-motorike që ndikojnë në mënyrën si komunikojnë njerëzit me makinat. Nëpërmjet shembujve konkretë të aplikacioneve, studentët duhet të kuptojnë parimet dhe të jenë të aftë t'i aplikojnë ato gjatë dizajnit të aplikacioneve të tyre.

- **Sistemet Sfariste Informative**

Qëllimet e lëndës: - Studentët të përfitojnë njohuri të sistemeve ERP (Enterprise Resource Planning), të zgjedhjes së softuerit ERP, si dhe integrimin e proceseve dhe transaksionet në ERP sistemin. - T'u mundësohet studentëve t'i kuptojnë sfidat në lidhje me implementimin e suksesshëm të sistemeve për menaxhim të zinxhirëve furnizues (Supply Chain Management systems). - T'u mundësohet studentëve t'i kuptojnë sfidat në lidhje me implementimin e suksesshëm të sistemeve për menaxhim të marrëdhënieve me konsumatorët (Customer Relationship Management systems). - Të zhvillohen aftësitë analitike dhe organizative të studentit përmes përdorimit të biznes studimeve të rastiit dhe të punës në grupe.

- **Vizualizimi i Informacionit**

Qëllimi i kësaj lënde është të përgatisë studentët me bazat dhe aftësitë e avancuara nga fusha e vizualizimit të të dhënave. Studentët do të mësojnë parimet e dizajnit dhe vlerësimit të vizualizimit, mësojnë se si të mbledhin grupe të mëdha të të dhënave, t'i përgatisin dhe analizojnë ato. Përveç kësaj, studentët do të mësojnë teknikat e vizualizimit të të dhënave më shumë dimensionale, të dhënave në kohë, tekstuale, gjeohapësinore, hierarkike, si dhe rrjeteve/grafikëve. Studentët gjithashtu do të përdorin mjete të tilla si Përpunimi, D3, R dhe ggplot2 si dhe shumë mjete të tjera për të krijuar prototipa të teknikave të mësuara për të vizualizuar grupet ekzistuese të të dhënave.

- **Menaxhimi i Projekteve**

Lënda paraqet një hyrje në fushën e menaxhimit të projektit softwar-ik, duke paraqitur teknikat dhe qasjet me qëllim të zhvillimit të një vetëdijeje kritike të sfidave dhe mangësive në kete fushe. Moduli bazohet në njohuritë e Inxhinierisë Softuerike dhe në lëndë tjera që lidhen me sistemet e informacionit.

- **Modelimi i Proceseve të Biznesit**

Proceset janë teknologjitë themelore të të gjitha organizatave për prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve që i plotësojnë nevojat e konsumatorëve. Gjithnjë e më shumë, për të vazhduar t'i shërbejë klientëve të saj dhe për të mbetur konkurrues, organizatave u kërkohet që vazhdimisht ta analizojnë, ridizajnojnë dhe përmirësojnë procesin e tyre kryesor të biznesit në afate të shkurtra kohore për të arritur qëllimet operacionale . Zbatimi i end-to-end integritit të procesit të biznesit e kërkon infrastrukturë që mundëson njerëzit, proceset dhe informacione të integrohet në mënyrë fleksibile. Kjo lëndë, do të shqyrtojë se si organizatat mund të modelojnë proceset e biznesit si hap të parë në arritjen e një biznesi fleksibël dhe të integruar. Kjo lëndë, do të shqyrtojë edhe teknologjitë e informacionit dhe arkitekturat që tregojnë premtimin për të zgjidhur integrimin e procesit të biznesit. Kjo lëndë do t'u ofrojë studentëve: • Kornizë për të kuptuar dizajnin, kontrollin dhe përmirësimin e proceseve të biznesit. Pjesa më e madhe e këtij materiali, do të merret nga fusha e menaxhimit të operacioneve. • Metodologjinë për analizimin, modelimin dhe dizajnimin e proceseve të biznesit, duke përfshirë përdorimin e simulimit për të matur dhe krahasuar performancën e modeleve të ndryshme. • Njohje të teknologjive dhe arkitekturave informatike aktuale dhe të atyre në zhvillim, si mundësues të përmirësimit të procesit të biznesit, integritit dhe automatizimit.

- **Marketingu Digjital**

Qëllimi i lëndës Marketingut Digjital është tu ofrojë studentëve njohuri për avantazhet e bizneseve që ofron marketingu digjital, si dhe rëndësinë e tij për suksesin e marketingut të një organizate. Marketingu Digjital paraqet vendin, ku takohen marketingu me internetin, si dhe me format e tjera të mediave të reja. Këtu përfshihen reklamata online, pjesëmarrja në media sociale, media të ndryshme digjitale, si dhe krijimi i një përmbajtjeje të marketingut, si psh: optimizimi i një faqeje interneti; optimizimi i SEO; përfitimi i njohurive themelore të Analitikës Google për matjet e efekteve të marketingut digjital, si dhe gjetjen e informacioneve rreth trendëve në të ardhmen. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara, do t'i ndihmojnë studentët të hartojnë dhe vlerësojnë një plan marketingu digjital, që të menaxhojnë me efikasitet performancën e marketingut digjital.

- **Punim Diplome**

Në këtë lëndë studentët do të punojnë në kompletimin e një projekti të aplikuar ose teorik. Qëllimi i lëndës është që t'u mundësojë studentëve t'i integrojnë njohuritë e fituara nga lëndët e programit studimor, në mënyrë që të ofrojnë një "produkt", qoftë softuer apo në formë teze. Në fund, studentët e dokumentojnë punën e tyre në formë të raporteve me shkrim dhe të prezantimeve gojore, të cilat vlerësohen nga një komision i fakultetit.

Lëndë zgjedhore

- **Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 1**

Programi për Gjuhën Maqedonase për Fillestarë 1, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit.

Përmes ushtrimeve të veçanta dhe ligjëratave u mundësohet studentëve ta njohin komunukimin bazë në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përshëndetjet, prezantimin, si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me të shkruarit dhe të kuptuarit të teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara, si dhe detyrave të vazhdueshme përmes, të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

- **Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 2, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, plainifikimi i aktiviteteve për periudhën e ardhshme, përshkrimi i personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh, që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje.

- **Gjuhë Maqedonase Niveli i Mesëm 1**

Lënda Gjuhë Maqedonase – Niveli i Mesëm 1, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit nëpërmjet të cilit studentët: do të pasurojnë fjalorin përmes teksteve të përshtatshme për aktivitetet e përditshme (në një bankë, në bibliotekë, në ministri, etj.) dhe do të përmirësojnë shkathtësitë për shkrimin profesional dhe të folurit që janë të nevojshem për komunikim të qartë dhe efektiv në karrierën e tyre të mëtejshme profesionale. Një theks i veçantë dhe i vazhdueshëm mbi aktivitetin e përgjithshëm është vendosur në elementet gjuhësorë, domethënë në drejtshkrimin dhe gramatikën e gjuhës standarde maqedonase. Ekspertët, si një nga elementët kyç për shprehjen e mirë me shkrim e përcaktojnë përdorimin korrekt të gjuhës.

- **Gjuhë Maqedonase Niveli i Mesëm 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase – Niveli i Mesëm 2, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit. Theks i veçantë vihet në zhvillimin e aftësive të komunikimit të studentëve, ose përdorimin e gjuhës në aktivitetet e përditshme dhe kontekstin profesional, duke pasuruar fjalorin dhe duke fituar njohuri për strukturën dhe llojet e teksteve profesionale. Do të përfshihen stile të ndryshme të komunikimit, me qëllim që studentët të krijojnë komunikim të mirë me publikun përmes teksteve të tyre dhe të tërheqin dhe mbajnë vëmendjen e tyre.

- **Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 1**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e mjedisëve të ndryshme profesionale. Studentët, pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata, gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përmbljes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturor.

- **Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 2**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e profesioneve të tyre të ardhshme. Ata, do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata, gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve.

- **Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë Shqipe për Fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë Angleze Nivel i Fillestarë**

Pas përfundimit të kësaj lënde studentët pritet të jenë në nivelin A1, sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane dhe të jenë në gjendje t'i kuptojnë dhe t'i përdorin shprehjet e njohura dhe frazat themelore për plotësimin e nevojave dhe kërkesave konkrete; të pyesin dhe të përgjigjen në pyetjet rreth identifikimit dhe marrëdhënieve personale; studentët duhet të jenë në gjendje të prezantojnë veten dhe të tjerët, duke i përdorur përemrat vetor dhe pronor, përshëndetjet, emërtimin e gjërave në klasë, ta dallojnë numrin njëjës dhe shumës. Studentët, duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë një ditë tipike, të njohin dhe të përdorin struktura të thjeshta gjuhësore për të përshkruar rutinën e tyre të përditshme; të flasin dhe shkruajnë për jetën e tyre, kohën e lirë; të pyesin dhe përgjigjen për ushqimet dhe pijet. Studentët, duhet të jenë në gjendje të dinë datat, ta përdorin në mënyrë të përshtatshme fjalorin e tyre lidhur me muajt e vitit, të bëjnë kërkesa të sjellshme, t'i përshkruajnë vendet, zgjedhin një destinacion dhe të japin udhëzime dhe të diskutojnë për preferencat e tyre.

- **Gjuhë Angleze Nivel i Mesëm i Ulët**

Në fund të kësaj lënde studentët pritet të jenë në nivelin A2, sipas Kornizës Evropiane Gjuhësore dhe duhet të jenë në gjendje t'i kuptojnë dhe t'i përdorin saktësisht shprehjet dhe frazat e duhura të një lloji konkret; të pyesin dhe tu përgjigjen pyetjeve në lidhje me identitetin personal, të përshkruajnë vende të ndryshme pune, bisedojnë dhe pyesin për jetën e njerëzve, të përshkruajnë aspektet e punës dhe caktojnë takime. Ata, duhet të jenë në gjendje të flasin për ngjarjet në të kaluarën, të përshkruajnë vendet, udhëtimet dhe historitë personale; zgjedhin një destinacion dhe japin udhëzime; të flasin për aktivitetet e përditshme, për obligimet gjate dites. Ata, duhet të jenë në gjendje të flasin për gjëra dhe punë në shtëpi, të kuptojnë dhe të japin këshilla dhe të shprehin mendimet e tyre; për të diskutuar preferencat e tyre.

- **Gjuhë Angleze Nivel i Mesëm**

Në fund të kësaj lënde studentët pritet të jenë në nivelin B1, sipas Kornizës Evropiane për Gjuhë. Ata, duhet të jenë në gjendje të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve rreth diplomave universitare, shkathtësive dhe situatave të punës; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave. Studentët, duhet të jenë në gjendje të pyesin, ose të përshkruajnë marrëdhëniet familjare dhe statusin martesor dhe duhet të jenë në gjendje të njohin dhe përdorin në mënyrë të përshtatshme fjalorin e lidhur me arsimin e lartë, artin, udhëtimin dhe sportin.

- **Gjuhë Angleze Nivel i Mesëm i Lartë**

Në fund të kësaj lënde studentët pritet të jenë në nivelin B2, sipas Kornizës Evropiane për Gjuhë; pritet që të jenë përdorues të pavarur të gjuhës angleze dhe të zbatojnë disa nga funksionet e mëposhtme gjuhësore: të japin këshilla; të kërkojnë dhe t'u përgjigjen pyetjeve rreth diplomave universitare, aftësive dhe situatave të punës; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë tekste dhe të dëgjojnë me hollësi, me qëllim që të kuptojnë idene dhe detajet.

- **Gjuhë Angleze Nivel i Avancuar**

Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, niveli i aftësisë së nxënësve, duhet të jetë në nivelin C1, sipas Kornizës Evropiane për Gjuhë. Si rezultat, studentët, duhet të jenë në gjendje, që me sukses të bëjnë prezantimin me gojë, të marrin pjesë në një forum debati / forum diskutimesh, ku shprehin mendimet dhe argumentet e tyre dhe t'u japin reagime të tjerëve në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët, duhet të jenë në gjendje të dëgjojnë dhe të lexojnë për t'i kuptuar detajet dhe të shkruajnë një paragraf argumentues dhe ese që shprehin mendimin e tyre. Ata, duhet të shkruajnë një paragraf dhe ese për një problem, si dhe zgjidhjen e tij. Studentet, duhet të jenë në gjendje të prezantojnë dhe paraqesin informacione vizuale në një formë të posterave, apo ne Power Point.

- **Gjuhë Gjermane**

Me përfundimin e lëndës nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimit të gjuhës. Deri në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët, gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane.

• Gjuhë Italiane

Qëllimi i mësimdhënies është që studentët të njihen me kulturën italiane, civilizimin Italian dhe gjuhën italiane. Ideja është që studentët të njohin një realitet tjetër, i cili do t'u ndihmojë në formimin e një ego të vetes, po ashtu edhe në krijimin e një fotografie për veten dhe të ardhmen e tyre. Në përputhje me nivelin (nga A1 deri B2), të cilën studentët do ta zgjedhin, ose nivelet, që do t'i ndjekin në semestrat që i kanë në dispozicion si një lëndë zgjedhore, materia thellohet në mënyrë progresive. Në nivelin e parë fillohet me të dhënat bazike, si p.sh: drejtshkrimi, shqiptimi, terminologjia për menaxhimin me situatat e ndryshme gjuhësore të përditshmërisë (prezantimi i vetes, prezantimi i të tjerëve, orientim në hapësirë dhe kohë, shprehje komunikuese në ndonjë lokal, në restorant, supermarket, në treg), ndërsa arrihet deri në konstruksione më të ndërlikuara në nivelet në vazhdim, që kanë të bëjnë me dhënien e një qëndrimi, dëshire, nevojë, sqarimi të ndodhive të shkuara, të folur të ndodhive të ardhshme, etj. Gramatika prezantohet në mënyrë induktive (nëpërmjet vetëdijesimit nga situatat (audio incizime, video filma, tekste) dhe sjellje të konkluzioneve), në të cilën rolin kryesor e kanë vetë studentët, me pjesëmarrjen e tyre aktive në ligjëratat.

• Gjuhë Frengje

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët t'i forcojnë bazat dhe aftësitë gjuhësore, si dhe t'i zhvillojnë katër kompetencat e komunikimit, veçanërisht në fushat e mëposhtme: të jenë në gjendje të shprehin një mendim, • të jenë në gjendje t'i shprehin ndjenjat, • ta kuptojnë thelbin e një shprehje, mendimi apo ideje, • të jenë të aftë të argumentojnë dhe mbrojnë mendimin e tyre. • të gjinden në situata të ndryshme, • të mbajnë një fjalim të thjeshtë dhe koherent, • të rrëfejnë një ngjarje, • të rrëfejnë një ëndërr ose përvojë, • të paraqesin arsyet për një projekt ose ide, • të komunikojnë në mënyrë spontane.

• Liritë dhe të Drejtat e Njeriut

Qëllimi i lëndës: Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet historike për t'i identifikuar ato. Me kalimin e kohës, korpusi i të drejtave dhe lirive të njeriut që mbrohen me ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare është zgjeruar, por kjo nuk do të thotë se ato respektohen në praktikë. Në fillim, të drejtat e njeriut konsideroheshin si çështje të brendshme të shteteve (sipas parimit të sovranitetit absolut të shtetit) dhe vetëm në kohërat më të reja ato fituan statusin e normave kogente. Kjo lëndë e studion zhvillimin e doktrinës për të drejtat e njeriut, llojet dhe kategoritë e të drejtave të njeriut dhe dokumentet kryesore që i rregullojnë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kjo lëndë ka për qëllim: t'i njoftojë studentët me konceptin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, me zbatimin e tyre dhe me ndikimin që ato kanë në formulimin e politikave kombëtare. Kjo do t'i inkurajojë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe të asaj kombëtare, do t'i vetëdijësojë ata për ndryshimet ndërkombëtare në këtë drejtim dhe për mënyrën se si këto të drejta ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Lënda do t'i nxisë që të kontribuojnë në përparimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

• Teknologjia Reproductive e Asistuar dhe e Drejta

Qëllimi i lëndës: Kjo lëndë ka për qëllim të theksojë faktin se në shoqërinë bashkëkohore, tanimë nuk ekziston një model universal i familjes dhe prindërisë. Me studimin e lëndës 'Teknologjia reproductive e asistuar dhe e drejta', studentët do të fitojnë njohuri rreth teknologjive të reja për reproduktimin artificial, të cilët janë pjesë e politikës bashkëkohore të natalitetit. Studentët, në detaje do të mësojnë për të gjitha metodat e reja të reproduktimit të qenies njerëzore, duke përfshirë: insimin artificial, in vitro fertilizimi, amësia surrogate, lindja e fëmijës nga një grua me spermë të donuar, reproduktimi post human, ko-prindëria (bashkëprindëria), ngjizja e fëmijës nga tre persona, krioprezervimi i gameteve ose embrioneve. Nëpërmjet kësaj lënde, studentët do të njoftohen se ekzistojnë edhe forma tjera, të cilat shkenca i ofron, por ende konsiderohen procese të ndaluara: klonimi, zgjedhja e gjinisë së fëmijës, përmirësimi i kapaciteteve fizike, intelektuale të fëmijës së ardhshme (eugenika), etj. Përmes studimit të kësaj lënde, pritet nga studentët që ta zhvillojnë mendimin e tyre kritik me anë të debateve për dilemat e shumta morale, etike dhe juridike lidhur me këto teknologji të reja për reproduktimin e qenies njerëzore.

• Komunikimi Ndërkulturor

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët, do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të lëndës, studentët do të fitojnë aftësi të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

• Krijimi i Ueb-it

Qëllimi i lëndës është zhvillimi i një ueb faqe të thjeshtë bazuar në standardet aktuale. Kërkon njohuri të gjuhës

Hypertext Markup Language (HTML) dhe Cascading Style Sheets (CSS). Shumica e ueb faqeve përdorin imazhe në formë të banerave, logove, imazheve, ose skanimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet e dizajnuara për ueb dhe për të lejuar krijuesit të zgjedhin këto imazhe në mënyrë që të zvogëlojnë madhësinë e skedarit. Fireworks gjithashtu mundëson integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo lëndë ofron një seri aktivitetesh që mundësojnë një hyrje gjithëpërfshirëse në HTML, CSS dhe krijimin e imazheve për ueb.

- **Dizajnimi i Medimeve Digjitale**

Qëllimi i lëndës është të dizajnojë dhe përpunojë grafika raster dhe vektoriale përmes programeve kryesore, siç janë Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe projektimin dhe botimin e materialeve komerciale për shtyp, duke përdorur Adobe In Design

- **Shkathtësi të TI për Produktivitetin e Zyrës**

Ky program krijon shkathtësitë që i ndihmojnë studentët ta përmirësojnë produktivitetin e tyre në klasë dhe TI karrierë. Programi ofron një gamë të gjerë të moduleve që përfshijnë: BAZAT KOMPJUTERIKE - shkathtësitë dhe konceptet që lidhen me përdorimin e pajisjeve, krijimin dhe menaxhimin e skedarëve, rrjetet dhe sigurinë e të dhënave. BAZAT E PUNIMIT ONLINE - shkathtësitë dhe konceptet që lidhen me ueb shfletuesit, kërkimin efektiv të informacionit, komunikimin online dhe me e-mail. PËRPUNIMI I TEKSTIT - shkathtësi për të kryer detyrat e përditshme që lidhen me krijimin, formatimin dhe përfundimin e dokumenteve të përpunimit të tekstit, siç janë letrat, CV-të dhe dokumente të tjera. PROGRAMI PËR TABELIM - shkathtësi për të kryer detyra që lidhen me zhvillimin, formatimin, modifikimin dhe përdorimin e një programi për tabelim (spreadsheet), përdorimin e formulave dhe funksioneve standarde dhe për të krijuar kompetenca dhe formatimin e grafikëve, ose tabelave. PREZANTIMET - shkathtësi për të krijuar prezantime standarde profesionale. Për të kryer detyra të tilla si krijimin, formatimin, modifikimin dhe përgatitjen e prezantimeve duke përdorur skeda të formave të ndryshme për prezantim elektronik dhe materiale të shtypura. PËRDORIMI BAZAVE TË TË DHËNAVE - shkathtësi për të përdorur bazat e dhënave në mënyrë efektive. Kuptim të koncepteve kryesore të bazave të të dhënave dhe demonstrim të aftësive për të përdorur aplikacionet e bazave të dhënave: krijimin dhe modifikimin e tabelave, pyetësorëve, formularëve dhe raporteve, si dhe përgatitjen e rezultateve të gatshme për shpërndarje. Të mësuarit për të lidhur tabelat dhe për të rifituar dhe manipuluar informacionin nga një bazë të dhënash duke përdorur mjetet e pyetësorëve dhe të renditjes.

- **Microsoft Office Access**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Aksesin 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 15 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-730.

- **Microsoft Office Excel**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Excel 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 13 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-727

- **Microsoft Office PowerPoint**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për PowerPoint 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-729.

- **Microsoft Office Word**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Word 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-725.

- **Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor**

Qëllimi i lëndës: Qëllimi i lëndës është që të ofrojë njohuritë themelore të shkrimit dhe arsyetimit juridik studentëve të drejtësisë dhe të kriminalistikës të vitit të parë. Në këtë lëndë, do të përfitohen njohuritë e shkrimit dhe arsyetimit juridik, parimet dhe udhëzimet themelore për të, duke zbatuar metodat e ndryshme të shkrimit juridik të akteve juridike normative (rregulloret, ligjet, vendimet, aktgjykimet, kontratat, testamentet, etj) dhe të akteve juridike jonormative (CV, kërkesa, konkursi, aplikimi, njoftimi, padia, etj). Për studentët e drejtësisë, kjo lëndë është më se e nevojshme që të përfitojnë shkathtësitë e shkrimit të duhur juridik, si dhe të arsyetimit të duhur të asaj që e shkruajnë juridikisht, sepse mjeshtria e të shkruarit juridik është thelbësore për çdo jurist në punën e tij të ardhshme profesionale.

- **E Drejta e Teknologjisë së Informacionit**

Qëllimi i lëndës: Qëllimi kryesor është që studentët të njihen me mundësitë e aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në profesionin juridik. Studentët, do të njohohen me bazat e përgjithshme konceptuale të informatikës juridike. Theks i veçantë është vënë në fitimin e aftësive, përkatësisht njohurive praktike në gjetjen dhe përdorimin e informacioneve juridike me ndihmën e teknologjive të reja, bazave të të dhënave dhe mjeteve të kërkimit. Studentët, gjithashtu do të njihen edhe me çështjet themelore të e-qeverisjes, e-tregtisë, e-prokurimit, e-drejtnesisë dhe e-demokracisë.

- **Zhvillimi Profesional i Karrierës**

Lënda është e dizajnuar që të zhvillojë dhe përmirësojë aftësitë dhe shkathtësitë e studentëve për të kërkuar punë si dhe të kenë sukses në vendin e tyre të punës. Kjo lëndë përfshin një pako të materialeve, ushtrimeve praktike dhe përvojë të personave nga praktika me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të studentëve për tregun e punës, e cila është gjithnjë e më shumë konkurrense. Lënda ka për qëllim t'i aftësojë studentët në përpilimin cilësor të CV-së, letrës së motivimit dhe përgatitjes së tyre për intervistë. Fushat shtesë, që trajtohen në këtë lëndë janë: vetëvlerësimi, analiza e vendit të punës, përshkrimi i vendit të punës etj. Kështuqë studentët në përfundim të lëndës pajisen me një portofol dokumentesh, të cilët do t'iu duhen për të aplikuar për punë dhe për të pasur avantazh konkurrues në tregun e punës.

- **Terminologjia Administrative dhe Nomoteknika**

Në këtë lëndë, studentët do të fitojnë njohuri themelore në lidhje me disiplinën shkencore të terminologjisë administrative dhe nomoteknikën, gjegjësisht teknikat e krijimit të projekt-akteve të legjisllacionit kombëtar. Gjithashtu, studentët do të mësojnë teknikat e krijimit të legjisllacionit ndërkombëtar, procedurat për miratimin e akteve ligjore (ligjet, aktet nënligjore) etj.

- **Zhvillimi i Shkathtësive Sociale**

Në këtë lëndë, studentët do të fitojnë aftësi individuale dhe ndërpersonale, do të krijojnë marrëdhënie pozitive me të tjerët përmes kuptimit të emocioneve, shpërndarje të dallimeve, zgjidhjes së konflikteve, dhënies ose marrjes së informatave kthyesë në mënyrë konstruktive. Ata bashkëveprojnë me sukses për të arritur konsensus nga palët e interesuara dhe vendimmarrësit dhe nxisin klimë pozitive të komunikimit brenda mjedisit sfidues të vendit të punës. Me anë të kësaj lënde ata rriten në krye të efektivitetit të tyre personal, ndihmojnë në zvogëlimin e kostos së rimëkëmbjes dhe të kostove të trajnimit dhe në mënyrë të konsiderueshme kontribuojnë në rritjen organizative.

- **Strategjitë për Kërkim të Karrierës**

Lënda është dizajnuar që t'u sjellë beneficione të gjithë studentëve, qoftë atyre që janë në procesin e kërkimit aktiv të punës, qoftë atyre që tanimë janë të punësuar. Lënda u ndihmon shumë studentëve në lidhje me kalimin e tyre nga një mjedis akademik në një realitet të punës, ku do të krijohet karriera e tyre. Ky kalim sjell ndryshime, e ndryshimet sjellin shumë pyetje për të panjohurën që zbulohet. Shpesh këto të panjohura lidhen me mundësitë, rrogën fillestare, potencialin për të fituar, rrezikun, sigurinë, lokacionin, trajnimin, konsideratat për stilin e të jetuarit, etj. Planifikimi i karrierës i ngjan një "rrote" me katër mbajtëse, e cila rrotullohet vazhdimisht dhe gjatë lëvizjes mbledh informata të reja lidhur me karrierën. Informatat e mbledhura përfshijnë të dhëna, të cilat ju ndihmojnë të gjeni përgjigje për pyetjet e juaja dhe ua lehtëson kalimin e sipërpërmendur.

- **Kapituj të Zgjedhur në Kompjuteristikë**

Kjo lëndë paraqet një hyrje të gjerë dhe të integruar në konceptet themelore të shkencave kompjuterike. Lënda mbulon tema, siç janë: historia e llogaritjes; logjika dhe sistemet digjitale; hyrje në arkitekturën kompjuterike, algoritme të thjeshta, zgjidhje problemesh dhe struktura të të dhënave; hyrje në gjuhët e programimit, sistemet operative, bazat e të dhënave, rrjetat, inxhinieria e softuerit dhe ueb-it; llojet e aplikacioneve, përfshirë edhe përshkrimin e disa programeve specifike (procesorë teksti, baza të dhënash, shfletues, etj.); procedimi i të dhënave tradicionale dhe multimediale.

- **Ueb-Teknologjitë**

Qëllimi kryesor i lëndës është që t'u japë studentëve njohuri praktike mbi mekanizmat themelore, shërbimet dhe protokollët e rrjetit global - Internetit. Lënda ofron mësimin e arkitekturës së përgjithshme të ueb faqeve efikase, bile dhe të sigurta. Studentët, do të fitojnë njohuri të thella teknike HTML-se (listat, tabelat, figurat, elementet multimediale dhe formularët), CSS (formatimi, stilet dhe layout-i), si dhe JavaScript (variablat, kushtet, ciklet dhe funksionet), të rëndësishme në krijimin e ueb faqeve.

- **Të Shkruarit Akademik në Gjuhën Angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët, do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njohohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të

vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthye e një pjese të shkruar, do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimitdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të shkruarit.

- **Të Shkruarit Akademik në Gjuhën shqipe**

Në fund të çdo niveli, studentët do të jenë në gjendje të shkruajnë ese dhe punime kërkimore bazuar në rregullat e mësuara gjatë ligjëratave. Më konkretisht, nga studentët pritet që t'i mësojnë funksionin, strukturën dhe llojet e ndryshme të paragrafëve, mënyrat se si të zgjedhin tema për punime kërkimore, si të grumbullojnë materiale, rregullat se si t'i dokumentojnë referencat e të arrijnë deri tek modeli përfundimtar.

- **Të Shkruarit Akademik në Gjuhën Maqedonase**

Pas mbarimit të kësaj lënde, nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të përshtatshme dhe komunikim të avancuar në gjuhën maqedonase me theks të veçantë në aftësitë e të shkruarit. Pos kësaj, pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm. Për më tepër, studentët do të jenë në gjendje t'i përmirësojnë aftësitë e tyre të shkruarit në më shumë nivele dhe në këtë mënyrë, do të bëhen më të sigurt dhe më kompetentë gjatë të shkruarit në gjuhën maqedonase. Studentët, do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin konkludime. Studentët, gjithashtu, do të zhvillojnë aftësi për shkrim dhe komunikim të shkëlqyer në gjuhën maqedonase.

- **Gjuhë Shqipe për Qëllime Specifike**

Lënda ka për qëllim përmirësimin dhe përsosjen e të shprehurit në gjuhën shqipe, qoftë me gojë ose me shkrim. Në mënyrë të veçantë lënda ka për qëllim t'i njoftojë studentët me terminologjinë specifike, mundësitë e përdorimit të saj, me përmirësimin e gabimeve më të shpeshta në të folurit e përditshëm, por edhe për komunikim të drejtë në rrethana specifike. Studentët, do të njoftohen me kushtet në të cilat ata rregulla hyjnë në përdorim, në mënyrë që të njëjtat të mund t'i përdorin jo vetëm për detyrat në lidhje me këtë temë, por edhe në karrierën e tyre të ardhshme profesionale.

- **Gramatika e Gjuhës Angleze në Praktikë**

Lënda është kryesisht i destinuar për studentët e nivelit të mesëm dhe të mesëm të lartë, studentët që kanë studiuar tashmë gramatikën bazë të gjuhës angleze. Ajo përqendrohet në ato struktura që studentët e emëruar duan t'i përdorin, por që shpesh u shkaktojnë vështirësi. Kursi në fjalë mund të shërbejë si bazë për përsëritje dhe si mjet për ushtrimin e strukturave të reja. Ndërsa studentët presin dhe kanë nevojë të mësojnë rregullat formale të një gjuhe, është e rëndësishme që ata të praktikojnë struktura të reja në kontekste të ndryshme në mënyrë që të internacionalizohen dhe të përvetësohen. Për këtë qëllim, kjo lëndë ofron një numër të mjaftueshëm të ushtrimeve të kontrolluara dhe komunikative, në mënyrë që studentët të mund të lidhin hendekun midis njohjes së strukturave gramatikore dhe përdorimit të tyre.

- **Gjuhë Angleze për Bashkëbisedim**

Gjuhë Angleze për Bashkëbisedim është lëndë një-semestrale e hartuar për folësit e gjuhës angleze të nivelit të mesëm dhe më lart. Lënda, do të jetë në dispozicion për studentët në të gjitha semestrat. Anglishtja është një gjuhë ndërkombëtare, që e lehtëson komunikimin në kontekste të ndryshme në mbarë botën, duke filluar nga takimet e biznesit dhe transaksionet në bisedat e rastësishme midis miqve dhe ndërveprimeve gjatë udhëtimit. Anglishtja, në bisedë, do të ndërtojë aftësitë e të dëgjuarit dhe të folurit e studenteve, duke ofruar gramatikë, fjalorin, shqiptimin dhe praktikën e rrjedhshmërisë së nevojshme për llojet e zakonshme të ndërveprimeve të folura angleze. Ky kurs, do të mbulojë tema që lidhen me bisedën profesionale, bisedat e rastësishme dhe ndërveprimet e përditshme, duke u siguruar studentëve besimin e bisedave në një kontekst të ndryshëm. Biseda profesionale, do të përfshijë lloje formale dhe të sjellshme të fjalimit të përdorura në kontekste të tilla, si takime pune, ose diskutime me kolegët. Biseda e rastësishme, do të përfshijë praktikën me gjuhën e përdorur gjatë shoqërimit me miqtë, ose familjen dhe situata të tjera joformale dhe do të përfshijë zhargon dhe fjalim joformal. Ndërveprimet e përditshme, do të përfshijnë biseda në dyqane, gjatë udhëtimit dhe duke kërkuar ndihmë. Metodat e të mësuarit, do të fokusohen në praktikë dhe do të përfshijnë aktivitete dëgjimi, dialogë, role, simulime, debate dhe diskutime.

- **Arsimim Online dhe Digjital**

Lënda Arsimimi Online dhe Digjital, është lëndë një-semestrale me 3 orë në javë, e cila ofrohet në studimet deridiplomike. Lënda është e përpiluar në bazë të nevojave të studentëve dhe në vete ngërthen shkathtësi të ndryshme të shekullit 21, të cilat janë të lidhura me përdorimin efektiv të teknologjisë. Lënda përmban tri kategori të shkathtësive të shek 21. Pas mbarimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të kërkojnë dhe të kenë qasje në informatat online, duke përdorur vegla të ndryshme digjitale, të vlerësojnë në mënyrë kritike vërtetësinë e materialeve online dhe të bëjnë dallim mes burimeve të vërteta dhe të rrejshme, të tregojnë mirëkuptim për problemet etike në kontekstin akademik, të kuptojnë si përdoren citatet në mënyrë të drejtë, të mësojnë si kryhet komunikimi profesional në mënyrë efikase, t'i kuptojnë gjërat bazike të sigurisë në internet, si dhe aspektet pozitive dhe negative të krijimit të

identitetit online, ta hetojnë shqetësimin-sajber dhe t'i identifikojnë zgjedhjet e mundëshme për zvogëlimin e online shqetësimeve.

- **Mbrojtja e Konsumatorëve**

Qëllimi i lëndës: Qëllimi kryesor është që studentët të njihen me kuptimin, burimet, marrëdhëniet me degët e tjera të së drejtës, subjektet (personat fizik dhe juridik), institucionet ligjore për mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtja përmes zbatimit të përgjegjësisë për shkak të defekteve fizike në artikull, mbrojtja e mangësive ligjore në artikull, mbrojtja e funksionimit normal saldimi, nëpërmjet përdorimit të rrjeteve administrative nga organet administrative, mbrojtja nga vendosja e standardeve, mbrojtja përmes masave ligjore, si dhe me procedurat e mbrojtjes së konsumatorit.

- **E Drejta Tregtare**

Qëllimi i lëndës: Qëllimi kryesor është që studentët të njihen me subjektet e së drejtës tregtare (tregtari, tregtari individual, shoqëritë tregtare), lidhja e shoqërive tregtare, ndërprerja e shoqërive tregtare (likuidimi dhe falimentimi), marrëveshjet tregtare, të drejtat e pronësisë industriale, letrat me vlerë.

- **Dhuna në Familje**

Qëllimi i lëndës: Dhuna në familje është një fenomen shoqëror me përmasa dhe shtrirje të gjerë edhe në shoqërinë bashkëkohore. Ajo është e pranishme në të gjitha shtetet e shoqëritë pavarësisht zhvillimit dhe emancipimit të tyre. Imune ndaj këtij fenomeni nuk është as vendi ynë e as rajoni në të cilin jetojmë. Andaj, studentët e drejtësisë përmes kësaj lënde fitojnë njohuri rreth asaj se çfarë është dhuna në familje, format në të cilat ajo manifestohet, rregullimet ligjore në vend, rajon dhe në sferën ndërkombëtare, si dhe mënyrat e parandalimit të saj. Përmes kësaj lënde, studentët në fund të lëndës, do të jenë në gjendje ta identifikojnë dhunën në familje, t'i identifikojnë veprat penale që inkriminohen në Kodin Penal si dhunë në familje, si dhe të zhvillojnë mendim kritik rreth kësaj problematike. Kjo lëndë e aftëson juristin e ardhshëm që gjatë ushtrimit të profesionit të tij si gjykatës, prokuror apo avokat t'i trajtojë në mënyrë sa më adekuate çështjet nga kjo sferë që kanë ndjeshmëri të lartë, si dhe të ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje sa më adekuate për viktimat e këtyre veprave penale.

- **Siguria Kompjuterike**

Qëllimi i lëndës: Siguria kompjuterike, do të eksplorojë elementët më të rëndësishëm që e formësojnë fushën e lëndës në të cilën shfaqen dhe menaxhohen problemet e sigurisë kibernetike. Lënda, do të theksojë se si kornizat etike, ligjore dhe ekonomike mundësojnë dhe kufizojnë teknologjitë dhe politikat e sigurisë. Ajo do të prezantojë disa prej makro-elementeve më të rëndësishme (siç janë konsideratat e sigurisë kombëtare dhe interesat e shteteve-nacionale) si dhe mikro-elementet (siç janë njohuritë e sjelljes në mënyrën se si njerëzit i kuptojnë dhe bashkëveprojnë me tiparet e sigurisë). Temat specifike përfshijnë hartimin e politikave (në nivel kombëtar, ndërkombëtar dhe organizativ), kornizat ligjore (duke përfshirë detyrat e sigurisë, çështjet e privatësisë, çështjet e qasjes në zbatimin e ligjit, sulmet në kompjuter dhe spiunazhin ekonomik/ushtarak), rolet e përdoruesve, qeverisë dhe industrisë.

- **Mediat Sociale dhe e Drejta**

Qëllimi i lëndës: Deri në fund të semestrit, studentët në këtë kurs do të jenë në gjendje të: identifikojnë të drejtat e tyre individuale, atyre që i referohen në mënyrë specifike mediave sociale dhe më gjerë; të përshkruajnë mënyrat në të cilat teknologjitë e reja të komunikimit po zhvillohen dhe vazhdojnë të ndikojnë në rendin tonë juridik dhe atë botëror; të krijojnë një pasqyrë se si mediat sociale, televizioni, interneti dhe teknologjitë e tjera të komunikimit ndikojnë në kuptimin e tyre të ligjit dhe të drejtësisë; klasifikimi i çështjeve ligjore që kompanitë e industrive të ndryshme mund të përballen kur integrojnë mediat sociale në praktikën e tyre të biznesit; të njohin pasojat potenciale pozitive dhe negative të prezencës së tyre personale në media.

- **Komunikimi Afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me konceptet e komunikimit të biznesit. Kjo lëndë është një përpjekje për të përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me tregues teorikë dhe para së gjithash me demonstrime praktike të mënyrës së drejtë të komunikimit në një mjedis organizativ me të punësuarit dhe menaxherët, si dhe mbajtjes së takimeve, intervistimin, se si të përgjigjen gjatë intervistës, negociimit dhe motivimit i të gjithëve në rrethin tyre.

- **Lidershipi dhe Zhvillimi Organizativ**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me mënyrën se si liderët dhe udhëheqësit i zhvillojnë dhe si i zbatojnë arritjet e misionit dhe vizionit në një organizatë të dhënë në sektorin publik; zhvillimin e vlerave të nevojshme për sukses afatgjatë dhe zbatimin e tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shprehive të përshtatshme; si liderët dhe udhëheqësit janë personalisht të përfshirë në sigurimin, që sistemet e menaxhimit të sigurisë, do të zhvillohen dhe zbatohen. Gjithashtu i njofton për mënyrën se si organizata e realizon misionin dhe vizionin e saj përmes një

strategjie të qartë të bazuar në pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara, të mbështetur nga të gjitha politikat relevante, planet, qëllimet dhe proceset.

- **Aftësitë e Komunikimit**

Lënda është dizajnuar t'u mundësojë studentëve që praktikisht ta zbatojnë komunikimin ndërpersonal. Studentët, do të mësojnë aftësi ndërpersonale, siç janë: perceptimi, të dëgjuarit, komunikimi verbal dhe ai jo verbal; do ta ushtrojnë të folurit publik, si për shembull: organizimin, prezantimin dhe bazat e të shkuarit fjalime publike. Studentët do të kenë mundësinë të praktikojnë komunikimin në grupe të vogla, duke filluar nga: lidershipi, vetëbesimi dhe të dëgjuarit. Lënda, po ashtu ofron njohuri themelore të nevojshme për ta kuptuar procesin e kërkimit të një vendi pune nëpërmjet komunikimit me shkrim dhe me gojë, duke shkruar rezyme, letër motivimi dhe duke simuluar intervista.

- **Zhvillimi i të Menduarit Kritik**

Studentët identifikojnë dhe përdorin aftësitë, proceset dhe teknikat e të menduarit kritik që do t'i ndihmojnë ata në karrierën e tyre dhe në jetën personale. Studentët i zhvillojnë aftësitë e tyre për të hetuar dhe vlerësuar mendimin nga këndvështrime të ndryshme dhe për të sintetizuar pozicionet e tyre në bazë të dëshmive në dispozicion. Gjithashtu, studentët praktikojnë teknika që u mundësojnë atyre të maksimalizojnë rezultatet që krijojnë gjatë çdo përvoje të tyre afatgjate të të nxënës, duke identifikuar, analizuar dhe formuluar zgjidhjet për problemet, kur ato paraqiten. Ata do të zhvillojnë strategji të të menduarit kritik dhe do t'i zbatojnë ato në lexim, shkrim dhe dëgjim. Studentët, do të zbatojnë strategjitë e pyetjeve, do të angazhohen në të menduarit reflektues, në zgjidhjen e problemeve dhe në testimin e argumenteve.

- **Marrëdhëniet me Publikun dhe Mediat e Reja**

Lënda, do të fokusohet në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të teknikave që janë të domosdoshme për funksionimin efektiv në epokën e globalizimit. Studentët, do të përpunojnë procesin e globalizimit, aspektet sociale, aspektet politike, ekonomike dhe kulturore të fenomenit modern, si dhe pasojat dhe ndikimet në sferën e komunikimit, të cilat njëherësh karakterizuan edhe një epokë të postmodernizmit, veçanërisht ndikimin e mediave të reja sociale, strukturën dhe funksionin e tyre, multilingualizmin në rrjetet sociale, efektet dhe pasojat në realitetet moderne të komunikimit në botë.

- **Anglishtja për Teknologjinë e Informacionit 1**

Kjo lëndë ofrohet me qëllim të përmirësimit të katër shkathtësive kryesore të gjuhës, siç janë: leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit në fushën specifike të përmbajtjes, si dhe rishikimi dhe avancimi i artikujve dhe fjalorit të përzgjedhur në nivel të mesëm dhe të mesëm të lartë në fushën e shkencave kompjuterike dhe teknologjitet. Kjo është bërë për t'u mundësuar studentëve të kuptojnë tekste më të komplikuar në këtë fushë dhe u mundësojnë atyre të komunikojnë me rrjedhshmëri me kolegët dhe ekspertët e fushës. Vëmendje e veçantë i kushtohet përdorimit të materialeve autentike për të ndjekur trendet dhe arritjet e fundit në këtë fushë.

- **Anglishtja për Teknologjinë e Informacionit 2**

Kjo lëndë ofrohet me qëllim të përmirësimit të katër shkathtësive kryesore të gjuhës, siç janë: leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit në fushën specifike të përmbajtjes, si dhe rishikimi dhe avancimi i artikujve dhe fjalorit të përzgjedhur në nivel të mesëm dhe të mesëm të lartë në fushën e shkencave kompjuterike dhe teknologjitet. Kjo është bërë për t'u mundësuar studentëve të kuptojnë tekste më të komplikuar në këtë fushë dhe u mundësojnë atyre të komunikojnë me rrjedhshmëri me kolegët dhe ekspertët e fushës. Vëmendje e veçantë i kushtohet përdorimit të materialeve autentike për të ndjekur trendet dhe arritjet e fundit në këtë fushë.

- **Metodologjitë e Hulumtimit në Biznes**

Kjo lëndë siguron një hyrje të plotë në metodologjinë e hulumtimit, teoritë dhe protokolet kërkimore dhe të shkruarit të propozimit për hulumtim. Studentët, në këtë lëndë, do të mësojnë për natyrën ciklike të të kërkuarit aplikativ, si dhe procesit iterativ të të shkruarit e një punimi hulumtues. Lënda, i mëson studentët se si ta identifikojnë idenë për studim, t'i formulojnë pyetjet hulumtuese dhe hipotezat, organizimin e literaturës së konsultuar dhe zgjedhjen e metodës përkatëse për hulumtim. Me përfundimin e kësaj lënde, studentët do të përfundojnë propozim-temën për hulumtim që përmban hyrjen, përshkrimin e problematikës (rëndësia e studimit), literatura e konsultuar, seksioni për metodologjinë, referencat dhe tabela për planin e përfundimit të temës.

- **Bazat e të Drejtës Tregtare**

Qëllimet e lëndës: - T'i pajisë studentët me njohuri themelore dhe të thelluara nga e drejta tregtare. Aspekti kryesor i programit studimor është orientuar në fitimin e njohurive të thelluara sa u përket tri lëmvive të mëdha të së drejtës

tregtare, respektivisht, pjesës statusore, kontratat tregtare dhe letrat me vlerë; - T'i pajisë studentët me njohuri të përgjithshme për mënyrën e themelimit dhe organizimit të subjekteve të së drejtës afariste, përfshi këtu edhe plotësimin e kushteve të përgjithshme për themelimin dhe regjistrimin e këtyre subjekteve (tregtarit individual dhe shoqërive tregtare si persona juridikë), si dhe mënyrën e shuarjes së subjekteve juridiko - afariste; - T'i pajisë studentët me njohuri themelore profesionale për marrëdhëniet juridiko - afariste, pjesëmarrësit në këto marrëdhënie juridike, llojet e marrëdhënieve juridiko - afariste, si dhe elementet përbërëse të tyre;

• Ueb Analitika

Qëllimi i kësaj lënde është t'u mundësojë studentëve ta zotërojnë internetin si një mjet biznesi, duke kuptuar bazat e ueb analitikës. Meqë, qëllimi i çdo ueb faqeje është të tërheqë klientë dhe ta rrisë rëndësinë e përmbajtjes që prezanton, është e nevojshme të zhvillohet një analizë e faktorëve që janë të rëndësishëm për përdoruesit. Për këtë qëllim, ne duhet të mbledhim të dhëna për ndërveprimin e përdoruesve me përmbajtjen e ueb faqes për të kuptuar sjelljet e tyre online dhe për përgatitur listën e rekomandimeve për ridizajnim të ueb faqes.

• Menaxhimi i Rrezikut

Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë të aftë: - Të identifikojnë dhe të kategorizojnë burime të ndryshme të rrezikut. - Të dizajnojnë procesin e menaxhimit të rreziqeve. - Ta kuptojnë rolin e menaxherit me rreziqe. - Ta kuptojnë rëndësinë të cilën e ka menaxhimi i rrezikut për aksionarët dhe aktorët tjerë (stakeholders). - Të mësojnë si të marrin vendime më të mira afariste, me të cilat arrihet kontributi më i lartë për nivelin e rrezikut të marrë. - Ta matin dhe ta vlerësojnë rrezikun duke zbatuar teknika dhe modele përkatëse (VaR, skenar-analizë, stres-test, etj.). - Të aplikojnë menaxhim të integruar të rrezikut.

• E-Tregtia

Qëllimet e lëndës: - Kuptimi dhe zbatimi i koncepteve të tregtisë elektronike - biznesit elektronik. - Identifikimi i nevojave të biznesit për adaptim të ndryshimeve konstante dhe të vazhdueshme në mjedisin dhe të rëndësishëm të inkorporimit të teknologjisë në proceset më të rëndësishme të biznesit. - Përmirësimi i efikasitetit të tyre aktual operativ për t'u transformuar në avantazh konkurrues. - Zhvillimi i planifikimit strategjik, administrativ dhe operativ për bizneset e reja, apo përmirësimi i planifikimit aktual me teknologjitë e tyre. - Të shpjegohen: rritja e e-biznesit deri më sot, koncepti biznes-konsumator dhe modeli biznes-biznes, duke përdorur teori relevante nga biznesi, menaxhmenti dhe shkencat shoqërore. - Të shqyrtohet: ndërveprimi midis trendeve teknologjike dhe biznes-konteksti social i e-biznesit, duke përfshirë edhe difuzionin e rrjeteve sociale dhe ndihodhjet në ueb 2.0.

• Zhvillimi i Aplikacioneve të Biznesit

Kjo është një lëndë konceptesh të programimit kompjuterik për studentët, që kanë përvojë të konsiderueshme të programimit, të cilët mund ta ndjekin këtë lëndë nëse dëshirojnë të mësojnë se si t'i zbatojnë përvojat e programimit në Visual Basic NET. Lënda, do të sigurojë njohuri pune nga programet kompjuterike dhe zbatimin e njohurive themelore të programimit në zgjidhjen e problemeve, duke shfrytëzuar teknologjitë Visual Basic dhe .NET, me qëllim që të fitohet një model organizativ i programimit. Lënda gjerësisht do ta promovojë përdorimin e modeleve të dizajnit, metodologjitë Object-Oriented në atë mënyrë me qëllim që t'i mësojë studentët me praktikatat më të mira në zhvillimin e aplikacioneve.

• Sjellja Organizative

Qëllimet e lëndës: Lënda "Sjellja organizative" është një nga lëndët themelore menaxheriale, që janë të përfshira në programet e fakulteteve ekonomike dhe shkollave afariste të ne dhe në rajon. Kjo lëndë ka për synim njoftimin e studentëve me sjelljen organizative dhe me psikologjinë organizative. Shikuar nga ky këndvështrim, lënda synon pajisjen e studentëve me njohuri nga një sërë problematikash si: lidhshipin, pushtetin, autoritetin, puna ekipore, konfliktet, rolin dhe rëndësia e individit në organizatën e biznesit dhe kështu me radhë. Marrë në përgjithësi, kjo lëndë përfshin qëllimet e përgjithshme vijuese: • Përfitim i diturisë (terminologji, klasifikime, trende); • Mësimi i parimeve dhe teorive bazike; • Mësim se si dituria e përfitur të zbatohet në praktikë (për t'u përmirësuar mënyra e të menduarit, aftësia për të zgjedhur problem dhe vendimmarja); • Zhvillimi i shkathtësive specifike, kompetencave dhe qasjeve të të menduarit për situatë dhe problem të caktuara; • Përfitimi i aftësive për të bashkëpunuar në grup dhe si pjesë e ekipit. • Nxitje e kreativitetit. • Zhvillimi i aftësive për shprehje të qëndrimeve në formë gojore dhe të shkruar; • Aftësim për të gjetur dhe valorizuar resurset e nevojshme për të mësuar dhe tejkaluar problemet; • Zhvillimi i qëndrimit mbi vlerat personale dhe zhvillimi i tyre; • Aftësim për të bërë analiza kritike të ideve, argumenteve dhe mendimeve; • Nxitje për të participuar në debate dhe për të hapur tema diskutimi;

• Analiza e të Dhënave dhe Sjellja e Vendimeve

Qëllimet e lëndës: Të ndërtohet një kapacitet për të krijuar një projekt në lëmin e Informatikës së Biznesit. Të krijohet projekti final në lëmin e Informatikës së Biznesit me temë të propozuar nga studenti dhe të miratuar nga udhëheqësi i lëndës. Projekti final duhet të përmbajë: 1. Propozim projektin, 2. Raportin final me shkrim dhe 3. Prezantimin.

- **Zhvillimi dhe Analiza e Proceseve të Biznesit**

Lënda adreson metodat dhe teknikat e nevojshme për të analizuar, dizajnuar, implementuar, automatoizuar dhe vlerësuar biznes proceset. Lënda është e strukturuar rreth fazave të ciklit jetësor të menaxhimit të biznes proceseve (MBP), ku studentët mësojnë se si ta analizojnë efikasitetin e organizatës prej prizmit të biznes proceseve, ridizajnojnë proceset nga aspekti i vlerës, dizajninin e biznes proceseve dhe implementimin e sistemeve të MBP, si dhe simulimin e dizajnit të proceseve të reja. Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje ta vlerësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e organizatave nga aspekti i biznes proceseve, të implementojnë projekte për përmirësim të biznes proceseve dhe ta përcaktojnë rolin e teknologjisë në përkrahje të proceseve të organizatës.

- **Biznes Modelet**

Qëllimet e lëndës janë të shpjegojnë rritjen e modeleve të ndryshme të biznesit dhe sidomos të biznesit elektronik deri në këtë moment, të modeleve biznesi - konsumatorët dhe biznes-për-biznes, duke shfrytëzuar teoritë relevante nga biznesi, menaxhmenti dhe shkencat shoqërore. Kjo lëndë gjithashtu analizon ndërveprimin midis trendeve teknologjike dhe kontekstit biznesor dhe shoqëror të biznesit elektronik, duke përfshirë difuzionin e zhvillimeve të rrjeteve shoqërore dhe teknologjive ueb 2.0. Studentët identifikojnë inovacionet brenda domenit të biznesit elektronik, duke prezantuar raste të shfrytëzimit inovativ të teknologjive të biznesit elektronik, prezantojnë teoritë relevante nga fushat e biznesit, menaxhmentit, shkencave shoqërore që ndihmojnë në shpjegimin e zhvillimit dhe rritjes së biznesit elektronik. Kjo lëndë shqyrton modelet dhe strategjitë e ndryshme të biznesit, duke përfshirë menaxhimin e zinxhirëve globalë të furnizimit dhe tregjet elektronike. Studentët njoftohen me nocionin e formave të reja organizative, siç janë: organizatat virtuale, tregjet elektronike dhe prodhimi me kod të hapur (open source), të cilët varen nga teknologjitë në fushën e biznesit elektronik. Qëllimi i përgjithshëm i lëndës është ta zhvillojë vlerësim kritik dhe reflektiv mbi ndikimin e inovacioneve dhe teknologjive të biznesit elektronik në aktivitetet biznesore.

- **Aplikimi dhe Hartimi i Projekteve të Biznesit**

Lënda i thekson çështjet kyçe për të kuptuar dhe për t'u ballafaquar me karakteristikat e ndryshme organizative dhe çështjet e dizajnit në organizata dhe në shoqëri. Ajo integron shqyrtimet e thella nga teoritë dhe zbatimet praktike në një ambient studimi të karakterizuar me angazhim aktiv të studentëve si individualisht ashtu edhe në grupe. Studentët, do të ballafaqohen me teknikat bazë të planifikimit dhe organizimit, do t'i vlerësojnë raportet midis projekteve, si dhe projekteve dhe ambientit përreth organizatës dhe do të reflektojnë në mënyrë kritike rolin e projekteve më gjerë në shoqëri. Kjo lëndë gjithashtu ka për qëllim refleksionin kritik se si strategjitë, interesat e ndryshme dhe të rëndësishme të palëve në organizatë, format e reja dhe trendet ndikojnë në atë që ne e konsiderojmë si dizajn i duhur organizativ.

- **Kërkimet Operacionale**

Qëllimet e lëndës: - Kujdes lidhur me përfshirjen e variablave dhe përkufizimit të tyre në suazat e matshmërisë dhe të vlerësohet se cilat të dhëna kanë të bëjnë me kuantifikimin e variablave dhe përcaktimin e ndërveprimit të tyre. - Zhvillimi i aftësisë dhe intuitës së nevojshme të menaxherëve për të njohur thelbin e problemeve dhe zgjidhjen e tyre të suksesshme; - Njohja e kufizimeve në lidhje me vlerat, të cilat mund të kenë këto variabla. - Komunikimi ideve dhe harmonizimi i punë ekipore - Formimi dhe zgjidhja e modeleve eksplicite me qëllime të inkuorpuara eksplicite, si dhe analiza sensitive me rastin e sjelljes së vendimeve; - Identifikimi dhe regjistrimi i vendimeve alternative, që ndikojnë në objektivat, si dhe ndërveprimi ndërmjet tyre;

- **Arkitektura Sistemore në Ndërmarrje**

Teknologjia e Informacionit është bërë pjesë integrale e strategjisë së suksesshme të biznesit. Arkitektura e Sistemit të Ndërmarrjeve (ASN), është duke u zhvilluar shpejtë, si një funksion kyç që mundëson sinergji midis TI-së dhe strategjisë së biznesit dhe shpërndarjes. ASN-ja paraqet hapin tjetër në të mësuarit e profesionistëve të rinj që kanë një sfond të fortë në algoritme, praktika inxhinierie të softuerit dhe bazës së të dhënave, rrjetëzimit dhe teknologjive të tjera të zhvillimit të softuerit. Kjo lëndë i zbaton këto mësimet dhe i prezanton shkathësitë për arkitekturën e zgjidhjes, arkitekturën e teknologjisë dhe arkitekturës së biznesit. Kjo është lënda e parë nga dy të tjerat për ndërtimin e aftësive të arkitekturës së ndërmarrjeve. Lënda, do të fokusohet në: • Evolucionin e koncepteve të arkitekturës së ndërmarrjeve - perspektivat e biznesit, teknologjisë dhe strategjisë. • Stilet arkitektonike dhe roli i tyre në përmbushjen e kërkesave arkitekturore. • Modele të arkitekturës dhe aftësive të biznesit. • Përfshirjen e projekteve për të praktikuar konceptet dhe përdorimin e mjeteve për ndërtimin e arkitekturave.

- **Hyrje në Planifikimin e Resurseve në Ndërmarrje**

Qëllimi i kësaj lënde është të njoftojë studentët me sistemet e planifikimit të resurseve të ndërmarrjeve (ERP) dhe funksionet e tij. Gjithashtu, i njofton studentët me mënyrën e punës dhe mënyrën e informimit të sistemeve të informacionit në veprimtaritë e biznesit. Më konkretisht, ka të bëjë me rishikimin e proceseve që përbëjnë ndërmarrjen afariste dhe se si softueri ERP mund të përmirësojë efikasitetin e këtyre proceseve të biznesit.

- **Financat Personale**

Lënda ofron një hyrje praktike për menaxhimin financiar personal. Duke përdorur një qasje të strukturuar, hap pas hapi, nxënësit mësojnë se si të ruajnë dhe investojnë, menaxhojnë kreditë studentore, taksat e dosjeve, ulin borxhin e kartës së kreditit dhe planifikojnë për të ardhmen. Skenarët e jetës reale, që mbulojnë një gamë të gjerë sfidash financiare, u mundësojnë studentëve të vlerësojnë rëndësinë e koncepteve kryesore dhe këshillat e dobishme nga ekspertët e financave personale i ndihmon ata të zbatojnë ato koncepte në jetën e tyre. Shumë shembuj të bazuar në matematikë ilustronë qartë rëndësinë kritike të arritjes së qëllimeve financiare afatgjata nëpërmjet investimit. Lënda i angazhon studentët dhe përqendron vëmendjen e tyre në konceptet kritike që kanë nevojë për sukses në klasë dhe për të menaxhuar financat e tyre me mençuri gjatë tërë jetës.

- **Ekonomiksi Menaxherial**

Qëllimet e lëndës: - T'u mundësojë studentëve t'u qasen problemeve menaxheriale vendimmarrëse, duke përdorur mendimin ekonomik; - Të paraqesin tema të praktikave të biznesit, duke përdorur një qasje analitike, duke përdorur ekuacione dhe qasje numerike;

- **Kontabiliteti Menaxherial**

Qëllimi i programit është që studentët të fitojnë njohuri të kontabilitetit, të cilat shfrytëzohen nga menaxherët për marrjen e vendimeve. Në mënyrë më specifike, të njihen studentët me konceptet e kontabilitetit për nevojat e menaxherëve dhe me mjetet e nevojshme për marrjen e vendimeve menaxheriale. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e Kontabilitetit.

- **Menaxhimi i Operacioneve**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri për t'u aftësuar: - Të përgatisin dhe të sjellin vendime me të cilat realizohen prodhimet dhe shërbimet. - Të përgatisin dhe të sjellin vendime me të cilat kontrollohen prodhimet dhe shërbimet. - Të gjejnë një qasje të përshtatshme për zgjidhjen e secilës situatë lidhur me problemet komplekse të prodhimeve dhe shërbimeve. - T'i mësojnë aktivitetet e ndryshme në organizatë dhe funksionimin e sistemit në tërësi të Menaxhimentit Operativ. - Të përgatisin dhe të sjellin vendime me të cilat krijohen kushte për prodhimet dhe shërbimet. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e menaxhimentit.

- **Ekonomia e Dijes**

Programi i lëndës u mundëson studentëve: - Të zhvillojnë një vizion holistik të gjendjes së artit, tendencat dhe sfidat e ekonomisë së bazuar në dije; - Të prezantojnë idetë, teoritë dhe industrinë bazë të ekonomisë së bazuar në dije; - Të shqyrtojnë dispozitat kryesore të menaxhimit të njohurive dhe të japë një bazë në praktikën dhe teknikat më të mira të menaxhimit të njohurive; - Futja e teknologjive të njohurive të përdorura nga bizneset, duke qenë baza e një sistemi efektiv të menaxhimit të njohurive; - Të demonstrojnë se si të identifikojnë proceset e njohurive në praktikë, t'i menaxhojnë ato duke përdorur IT; - Të specifikojë kriteret e formimit dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor; - Të analizojë praktikën më të mira, sfidat dhe mundësitë e zbatimit të ekonomisë së bazuar në dije në Maqedoni dhe vende të tjera duke rishikuar dhe vlerësuar tiparet e zhvillimit modern të ekonomisë së bazuar në dije; - Të përgatisë studentët për të vepruar në një mjedis të ndërmarrjeve dinamike në kontekstin e menaxhimit të kapitalit intelektual.

- **Bazat e Ekonometrisë**

Qëllimet e programit të lëndës: - Të zhvillohet një kuptim për përdorimin e analizës së regresionit dhe teknikave përkatëse për përcaktimin sasior të marrëdhënieve ekonomike dhe testimin e teorive ekonomike; - T'i aftësojë studentët t'i lexojnë dhe t'i vlerësojnë studimet empirike në revista profesionale; - T'i pajisë studentët me përvojë praktike të përdorimit të programeve të zakonshme të regresionit që përshtaten me modelet ekonomike;

- **Komunikimi Afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me konceptet e komunikimit të biznesit. Përmbajtja e programit është si në vijim: në vitet e fundit shumica e kompanive përdorin teknikat e komunikimit të biznesit, si një mjet kyç për t'iu përgjigjur konkurrencës gjithnjë e më të ashpër në tregun global. Kjo lëndë është një përpjekje për të përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me tregues teorikë dhe para së gjithash me demonstrime praktike të mënyrës së drejtë të komunikimit në një mjedis organizativ me të punësuarit dhe menaxherët, si dhe mbajtjes së takimeve, intervistimit, se si të përgjigjen gjatë intervistës, negociimit dhe motivimi i të gjithëve në rrethin tyre.

- **Parimet e Bankierisë dhe Financave**

Qëllimi i lëndës: - Të mundësojë diskutim për sistemet financiare, pse ekzistojnë ato dhe si janë të strukturuar; - Të shpjegojë pse rëndësia relative e ndërmjetësve financiarë dhe tregjeve financiare është e ndryshme në vende të ndryshme të botës dhe si sistemet e bazuara në banka dallojnë nga sistemet e bazuara në treg; - Të mundësojë të kuptohet se pse ekzistojnë ndërmjetësuesit financiarë dhe të diskutohet për rolin e kostove të transaksionit dhe teorive mbi informacionet asimetrike në sigurimin e një justifikimi ekonomik; - Të shpjegojë pse bankat kanë nevojë

për rregullim, t'i ilustrojë arsyet kryesore për dhe kundër rregullimit të sistemit bankar; - Të mundësojë diskutim rreth llojeve kryesore të risqeve me të cilat përballen bankat dhe t'i përdorin teknikat kryesore të përdorura nga bankat për të menaxhuar me risqet; - Të shpjegojë se si të vlerësohen aktivet reale dhe ato financiare dhe të mund të përdorin teknikat kryesore të buxhetimit të kapitalit (Neto vlera aktuale Norma e brendshme e kthimit); - Të shpjegojë se si të vlerësohen aktivet financiare (obligacionet dhe aksionet); - Të mundësojë të kuptohet se si risku ndikon në kthimin e aktiviteteve me risk si dhe si risku ndikon në vlerën e aktives në ekuilibër në bazë të paradigmave të çmimeve të aktiveve themelore (Modeli i çmimit të aktiveve të kapitalit dhe teoria e çmimeve të aktiveve); - Të mundësojë diskutim nëse çmimet e aksioneve i reflektojnë të gjitha informatat në dispozicion dhe të vlerësojë evidencën empirike mbi efikasitetin e informatave në tregjet financiare.

- **Menaxhmenti i Burimeve Njerëzore**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me rolin dhe rëndësinë e Menaxhmentit të Burimeve Njerëzore në organizatat bashkëkohore të biznesit. Në kuadër të kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri lidhur me menaxhmentin e procesit të burimeve njerëzore, si në teorinë ashtu edhe në praktikën e kompanive ndërkombëtare dhe vendore. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë:Parimi i Menaxhmentit.